

## Informacion Mujor – Mars 2021

|                       |  |
|-----------------------|--|
| Emri i Fondit         | Fondi i Pensioneve Vullnetare "SIGAL"  |
| Struktura Ligjore     | Fond Pensioni*   |
|                       | Licensuar nga AMF me licensë nr. 2, datë 30.03.2011                                  |
| Administrimi i Fondit | Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit "SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA" Sh.a. |
| Themeluar             | Janar 2006   |
| Monedha               | Lekë   |
| Banka Depozitare      | Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.  |
| Auditues              | Grant Thornton Sh.p.k.   |

\*Rregulluar nga Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"

|                                       |                          |
|---------------------------------------|--------------------------|
| Komision në Hyrje                     | 0%                       |
| Komision në Dalje                     | 0%                       |
| Komision Vjetor Administrimi          | 2.20%                    |
| Penalitet për tërheqje të parakohshme | Sipas Rregullores së AMF |
| Komision Performance                  | 0%                       |
| Shuma fillestare e kuotës             | 1.000 Lekë               |
| Kontributi fillestar minimal          | 1.000 Lekë               |
| Kontributi minimal pasues             | 1.000 Lekë               |

### Objektivat dhe Politika e Investimit

#### Objektivat e Investimit

Fondi i Pensioneve ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

#### Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

### Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Mars 2021

|                                    |                       |
|------------------------------------|-----------------------|
| Vlera Neto e Aseteve               | 1,640,254,104.99 Lekë |
| Numri i anëtarëve                  | 8,685                 |
| Çmimi i Kuotës                     | 1,508.7588 Lekë       |
| *Fitimi vjetor (31/03/20-31/03/21) | 3.60%                 |
| **Kohëzgjatja                      | 4.25                  |

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi  
\*\*Kohëzgjatja në datën e raportimit 31.03.2021

### Portfoli i Investimeve në datën 31 Mars 2021

#### Përbërja e portofolit




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive

#### Përbërja e portofolit





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.

**Për Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL" treguesi është në nivelin 1, ose nivelin më i ulët i rrezikut.**

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portfoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Treguesi është i bazuar në të dhënat historike të 5 viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

## Performanca e Fondit

Performanca e Fondit deri në 31.03.2021

Gjatë muajit Mars 2021 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për këtë muaj ka rezultuar 0.295%.

Fitimi vjetor neto (%) për 12 muajt e fundit (Periudha: 31 Mars 2020 – 31 Mars 2021) ka shënuar nivelin 3.60%.

Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.


### Performanca vjetore (%)

|       | 2016        | 2017        | 2018        | 2019        | 2020        |
|-------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Fondi | <b>5.03</b> | <b>4.55</b> | <b>4.30</b> | <b>4.17</b> | <b>3.53</b> |


### Rritja e Vlerës Neto të Aseteve (%)

|       | 2017-2018    | 2018-2019    | 2019-2020    |
|-------|--------------|--------------|--------------|
| Fondi | <b>24.63</b> | <b>22.20</b> | <b>19.45</b> |


### Fitim vjetor neto (%)



### Ecuria e Çmimit të Kuotës



## Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një trend kryesisht rënës gjatë muajit Mars, ku të gjithë titujt për të cilët janë zhvilluar ankande kanë shënuar rënie, përpos Bono Thesari 12 mujore. Raporti i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.87 në rritje nga 0.93 raport mbulimi gjatë muajit Shkurt 2021.

Rendimenti i Bonove 12-mujore të Thesarit gjatë muajit Mars arriti nivelin 2.167% nga 2.14%, me një rritje prej 0.03%. Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 2.63% nga 2.65% me rënie prej 0.02%, krahasuar me ankandin paraardhës.

Obligacioni 5 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.875% nga 4.22%, me një rënie prej 0.35% krahasuar me ankandin paraardhës. Për obligacionin 7 vjeçar, rendimenti ka rezultuar në nivelin 4.25% nga 4.52% në rënie me 0.27% në krahasim me ankandin paraardhës.

Për obligacionet e maturiteteve 3 vjeçare dhe 10 vjeçare nuk janë zhvilluar ankande në muajin Mars, ndërkohë në ankandet paraardhëse, këto tituj kanë rezultuar me rendiment përkatësisht në nivelet 3.04% dhe 5.38%.

## Informacion Praktik

### Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 88, 89 dhe 90 të ligjit nr.10 197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

### Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensioneve Vullnetare "SIGAL". Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondit të Pensionit Vullnetar "SIGAL" dhe në <https://fondisigal.com.al/>

### Kontakt:

Rr. "Donika Kastrioti", Tiranë

Phone: +355 (0) 44 511 666

Email: [info@fondisigal.com.al](mailto:info@fondisigal.com.al)